

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh. K. nga D. R. e Shqiperise, për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijes kufitare nga neni 146 par. 1 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore te shtetit në Prizren PP.II.nr.3024/2017 të datës 14.11.2017, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit te shtetit në Prizren Sahide Sefa, te akuzuarit me datë 15.11.2017, morri dhe shpalli publikisht këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari

Sh. K. nga i ati A., e ëma F., e vajzërisë A. i lindur më datë në D. R. e Shqiperise, ku edhe tani jeton rr. lagjja, ka të kryer shkollën fillore, i pa pune, i pamartuar, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqiperise.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt.13.11.2017, rreth ores 11,00 min, gjate patrullimit ne zonen e kufirit ne V. ne afersi te liqenit, te bere nga zyrtaret e policis, eshte verejtur i dyshuari i cili ka kaluar piken kufitare Shqiperi – Kosove, jashte vendkalimit te autorizuar te kufirit,

-kësodore kryen veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijes kufitare nga neni 146 par.1 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 3 par.2, 7, 8, 9, 10, 23 par.2, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75, te KP-se, dhe neni 365 te KPP-es te akuzuarit i shqipton:-

DENIM ME GJOBË

Në shumën prej **250 (dyqindpesdhjete) euro**, të cilën shumë të denimit me gjobë, i akuzuari është i obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmersië së këtij aktgjykimi, nëse denimi me gjobë nuk ekzekutohet as me detyrim i njeiti do të zëvendësohet në denim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro një ditë burg, respektivisht **12 ditë burgim**,

I akuzuari obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sa do të bëhen ato në bazë të llogaris së gjykatës, si dhe shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor, shumë prej **30,00 euro**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmersi së këtij aktgjykimi.

Arsyetim

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP. nr.II.3024/17 te dt.14.11.2017, kunder te akuzuarit sh K nga D R. e Shqiperise, per shkak te vepres penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijes kufitare nga neni 146 par.1 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim kryesor ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimi te fajesise per vepren penale e cila i vihete ne bare, e qe pranimi i fajesise eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykat ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijes kufitare nga neni 146 par.1 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, me pare i pagjykuar, cka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive ne kuptim te dispozitave te nenit 74, 75, e 76 gjykata morri per baze edhe faktin qe i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tije ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka pranuar fajesin dhe ka shprehur keqardhje per vepren e kryer penale dhe poashtu edhe ka pasur sjellje korrekte para gjykates, andaj gjykata i shqiptoi denimin me gjobe sepse konsideron se me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete i kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla.


Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr. 2112/2017 të datës 15.11.2017

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari



Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK: Kunder këtij aktgjykimi pala e pakenaqr ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.